



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I DREJTËSISË

DEKANI

Nr 12 Prot.

Tiranë më 14/01/2023

Drejtuar: Prof. Dr. Ethem Ruka
Rektor i Universitetit "Luarasi"

Lënda: Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Drejtësisë për vitin akademik 2024-2025

I nderuar Rektor,

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, në propozimet e Departamenteve të së Drejtës Penale, Priyate dhe Publike, Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë, në mbledhjen e tij të datës 14/01/2023, vendosi mbi miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Drejtësisë, për vitin akademik 2024-2025.

Gjeni ju lutem bashkangjitur vendimin përkatës.

DEKANI


Prof. Dr. MAKSIM HAXHIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I DREJTËSISË
D E K A N I

V E N D I M

Nr. 1, Datë 14.01/2023

“Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Drejtësisë për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë, i mbledhur në datën 14.01/2023, pasi diskutoi për propozimet e përcjella nga Departamentet e së Drejtës Penale, Private dhe Publike për kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Drejtësisë, për vitin akademik 2024-2025,

V E N D O S I:

1. Në programin e integruar të ciklit të dytë të studimeve në “Drejtësi” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
 - i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
 - ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
 - iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - b) dhe me 20% mesataren për lëndën me zgjedhje të maturës shtetërore.



3. Në programin e studimit **“Master i Shkencave”** në **“E Drejtë Penale”** pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
- Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
 - Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Shkenca sociale me programe të ngjashme me fushën e Drejtësisë si: Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Akademia e Rendit, Akademia e Policisë, Psikologji etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MAS, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
 - Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
 - Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
 - Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.
4. Në programin e studimit **“Master Profesional”** në **“Siguria dhe Rendi Publik”** pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
- Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
 - Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Drejtësi apo diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor në programe të

LUARASI

ngjashme me fushën e Drejtësisë si: Shkenca Politike; Diplomaci; Marrëdhënie Ndërkombëtare, Akademia e Rendit, Akademia e Policisë, Psikologji, Teknologji Informacioni dhe Inovacioni etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MAS, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.

- i. Kanë të drejtën e pranimi vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Përpara përfundimit të studimeve Master Profesional të mbrojnë provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori - Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2024-2025.

DEKANI


Prof. Dr. MAKSIM HAXHIA

